



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 26 datë 10.5.2022**

**“PËR DISA SHTESA NË VKB NR. 49 DATË 30.10.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PËRFITUESVE PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE “PËR FAMILJEN NR. 6” (PRANË ISH KONVIKTIT TË SHKOLLËS PYJORE)”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 10.5.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; pikës 5 të neni 15 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social“, pikës 18 të VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM nr. 301 datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët; Marrëveshje bashkëpunimit “Për strehimin e jetimëve në qytetin e Shkodrës”, ndërmjet Ministrisë së zhvillimit Urban dhe Bashkisë së Shkodrës, nr. 2691 prot.datë 07.03.2016, VKB nr.49, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen nr. 6” (pranë ish konviktit të shkollës pyjore); “Proçes-verbal përfundimar i Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër nr.5281/1 prot. datë 08.04.2022“ si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë disa shtesa në VKB nr. 49, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës

Komunitare “Për familjen nr. 6” (pranë ish konviktit të shkollës Pyjore)” sipas tabelës bashkengjitur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**



**Brisela KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak



**Denis Lesha**

Miratuar me 29 vota  
Vota Pro 29  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 12.5.2022

Programi: Banesa Sociale me Qira (QKF nr. 6)

Lënda: lista e perfituesve

Nr. Rendor	Emri / Atësia / Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi
1	Matilda Ismail Rrapushi	1	Garsonier	Nuk ka banesë në Pronësi		Jetime, Ejiptiane	26.000 Lekë	Privat
2	Arben Sokol Rrhnaj	1	Garsonier	Nuk ka banesë në Pronësi		Jetim	Pa të ardhura	Pa punë
3	Flora Kol Ndoja	4	2+1	Nuk ka banesë në Pronësi	F:njëprindërore	Viktimitë Dhune	Pa të ardhura	Nd.Ekonomike
4	Bora Sokol Shpendi	3	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi	F:njëprindërore	Vajzë Mënë	25.000 Lekë	Privat
5	Valbona Hasan Milani	3	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi	F:njëprindërore		Pa të ardhura	Pa punë


